

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6823  
E shtunë, 11 shkurt 2023  
çmimi 0.40 €

## Kontratat kolektive "gjunjëzojnë" komunitat

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD) KA PARAQITUR RAPORTIN  
ME TITULL "PLANIFIKIMI (JO)ADEKUAT I QEVERISË" | FAQE 4-5

# QEVERIA S'KA ARRITUR T'I MIRATOJË AS GJYSMËN E PROJEKTLIGJEVE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022



Në raportin me titull "Planifikimi (jo)adekuat i qeverisë", i paraqitur të premtën nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), u theksua se Qeveria e Kosovës nuk ka arritur t'i miratojë as

gjysmën e projektligjeve të planifikuara për vitin 2022. Autori i këtij hulumtimi, Naim Jakaj, ka thënë se qeveria ka miratuar 71 nga 171 projektligjet e planifikuara. Sipas tij,

nga 71 projektligjet e miratuar, 39 janë miratuar sipas planifikimit, ndërsa 32 projektligje janë miratuar duke mos e respektuar afatin e planifikuar

**THAÇI BËN KËRKESË  
URGJENTE,  
INSISTON QË  
9 DËSHMITARËT  
PRO TIJ TË  
THIRREN NË GJYQ  
QYSH NË MARS** | FAQE 5



**HAXHIU I KËRKON  
PROKURORIT TË  
TËRHIQET NGA  
AKTAKUZA PËR  
GAZIN LOTSJELLËS:  
DORËZOHU,  
S'ËSHTË VONË** | FAQE 6



## AKTUALE



**MACRONI I JEP ZELENSKYT  
MEDALJEN E NDERIT TË FRANCËS**

F. 2

**ÇOLLAKU PËR PLANIN  
FRANKO-GJERMAN: NË THELB  
TË TIJ ËSHTË ASOCIACIONI,  
E JO NJOHJA RECIPROKE** F. 5

**16 VJET NGA VRASJA E ARBEN  
XHELADINIT DHE MON BALAJT,  
KURTI ME BASHKËPUNËTORË  
BËJNË HOMAZHE** F. 3



## EKONOMI



**KUVENDI MIRATON VLERËN  
E KOEFICIENTIT TË PAGAVE** F. 8

## SPORT



**TË DIELËN DERBI PEJA - PRISHTINA**

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Mbi 21 mijë të vdekur nga pasojat e tërmetit në Turqi dhe Siri

ANKARA, 10 SHKURT - Tërmeti që goditi rajonin pranë kufirit në mes të Turqisë dhe Sirisë tashmë ka marrë jetën e më shumë se 21 mijë personave. Ky rajon është shtëpi e 13.5 milionë njerëzve.

Ekipet e kërkim-shpëtimit bënë përpjekjet e fundit gjatë natës të së enjtes për të gjetur të mbijetuar nën rrënojat e ndërtesave të shembura.

Pamje të realizuara me dronë nga lartësia shfaqën shkatërrimin e lënë pas, me lagje të tëra të rrafshuara.

Shifra e re, e cila me siguri do të rritet, përfshin mbi 18 400 njerëz të vdekur në Turqi dhe më shumë se 3 300 në Sirinë tashmë të shkatërruar nga lufta civile. Gjithashtu, dhjetëra mijëra njerëz u lënduan.

Edhe pse ekspertët thonë se njerëzit mund të mbijetojnë për një javë ose më shumë, shanset për të gjetur të mbijetuar në temperaturat e ulëta po zbehën.

Ndërsa ekuipazhet e emergjencës dhe të afërmit në panik gërmuan nëpër rrënoja - dhe herë pas here gjenin njerëz të gjallë - fokusi filloi të zhvendosej në prishjen e strukturave të rrezikshme të paqëndrueshme.



Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, e quajti tërmetin "fatkeqësia e shekullit". Në veriperëndim të Sirisë, gjatë natës, të enjtes, më 9 shkurt, mbërritën kamionët e parë të OKB-së që kur ndodhi tërmeti që

hynë në zonën e kontrolluar nga rebelët nga Turqia, duke nënvizuar vështirësinë për t'u ndihmuar njerëzve atje. Numri i të vdekurve nga tërmeti me magnitudë 7.8 shkallësh i së hënës kaloi numrin e më shumë

se 18 400 të vdekurve nga tërmeti i vitit 2011 që shkaktoi një cunami në Fukushima, Japoni, si dhe tërmetin e vitit 1999 pranë kryeqytetit turk, Stamboll, që u mori jetën rreth 18 mijë personave.

### Pjesëtari i FSK-së rrëfen shpëtimin e dyvjeçares

"Kemi arritur të identifikojmë zëra të cilët kanë ardhur nga thellësia. Në fillim nuk ka qenë e qartë se nga po vijnë. Me mjetet tona që i kemi, ne kemi arritur saktë ta identifikojmë vendndodhjen. Kur janë afruar [ekipet], fillimisht kanë arritur ta prekin nënën e fëmijës, e ka pasur fëmijën në dorë ashtu siç e kanë zënë gërmadhat. Kemi marrë kërkesë nga nëna që ta shpëtoj fëmijën. Na tha: 'Ju lutem, nxirreni vetëm fëmijën, vetëm fëmijën nxirreni'". Kështu rrëfen për "Radion Evropa e Lirë" përvojën e shpëtimit të një vajze dyvjeçare në Hataj të Turqisë, më 8 shkurt, Egzon Syla, komandant i kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës për kërkim-shpëtim, i angazhuar në Turqi pas tërmetit që e ka goditur këtë vend më 6 shkurt.

## Macroni i jep Zelenskyt Medaljen e Nderit të Francës

PARIS, 10 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, është pajisur me Medaljen më të Lartë të Nderit të Francës. Por, kanë një problem: presidenti rus, Vladimir Putin, ka të njëjtën medalje. Presidenti francez Emmanuel Macron mbërtheu Medaljen e Kryqit të Madh të Nderit rreth krahavorit të Zelenskyt, pasi të dy u takuan në pallatin presidencial francez të enjtes, një veprim që Macroni tha se kishte për qëllim ta tregonte "njohjen e Francës" për trimërinë e Ukrainës që kur Rusia e

pushtoi atë gati një vit më parë. Zelensky, në udhëtimin e tij të dytë jashtë vendit që nga pushtimi rus, u takua më 8 shkurt në Paris me Macronin dhe kancelarin gjerman Olaf Scholz. Disa ligjvënës dhe aktivistë francezë i kanë bërë thirrje Macronit ta revokojë nderin që i është bërë Putinit me të njëjtën medalje për shkak të luftës. Macroni nuk e përjashtoi mundësinë e heqjes së nderit dhënë Putinit nga presidenti i atëhershëm, Zhak Shirak, në vitin

2006. Macroni u tha gazetarëve të premtën se një vendim i tillë "ka kuptim serioz dhe duhet të merret në momentin e duhur". Ai vuri në dukje se e ka anuluar nderin edhe në të kaluarën. Macroni ia hoqi mirënjohjen e lartë producentit të Hollivudit, Harvey Weinstein, pas akuzave për abuzime seksuale kundër tij në vitin 2017. Çiklistit dhe ish-yllit të Tour de France, Lance Armstrong, iu hoq gjithashtu kjo mirënjohje.



## Aleanca për Shqiptarët, pjesë e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut



SHKUP, 10 SHKURT - Qeveria e Maqedonisë së Veriut do të zgjerohet edhe me një parti politike, Aleancën për Shqiptarët (ASh), e cila deri tani ishte në opozitë. Vendimi u bë me dije të enjtes në mbledhje nga kryetari i kësaj partie, Arben Taravari, pas bisedimeve disaditëshe me kryeministrin maqedonas Dimitar Kovaçevski. Kjo parti ka tetë deputetë dhe me përfshirjen në qeveri do t'i krijojë stabilitet qeverisë aktuale që përbëhet nga Lidhja Social Demokratike (LSDM), Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) dhe disa parti

më të vogla, por që kanë 64 deputetë, apo vetëm 3 më shumë se numri i nevojshëm për funksionimin e shumicës parlamentare. Arben Taravari, kryetari i Aleancës për Shqiptarët, tha se pjesëmarrja e kësaj partie në qeveri ka të bëjë me "ruajtjen e kursit evropian të Maqedonisë së Veriut". "Me parimet e platformës për bashkëpunim me Aleancën e Shqiptarëve, të miratuara nga organet partiake, sigurohen të gjitha kushtet për stabilitet politik dhe rritje të efikasitetit të Kuvendit dhe të

institucioneve... Pjesëmarrja jonë në qeveri është në funksion të stabilitetit të vendit, miratimit të ndryshimeve kushtetuese dhe vazhdimit të kursit evropian të Maqedonisë së Veriut", ka deklaruar Arben Taravari, kryetar i Aleancës për Shqiptarët. Kjo parti në qeveri do të ketë një post të zëvendëskryeministrit për investimet kapitale, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, dy pozita të zëvendësministrave të Mbrojtjes dhe Bujqësisë, dy sekretarë shtetërorë, si dhe disa drejtori.

# 16 vjet nga vrasja e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt, Kurti me bashkëpunëtorë bëjnë homazhe

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 SHKURT - Të premten janë mbushur 16 vjet nga demonstrata e 10 shkurtit e Lëvizjes Vetëvendosje, në të cilën demonstratë, nga policia rumune e UNMIK-ut, u patën vranë aktivistët e LV-së, Arben Xheladini dhe Mon Balaj.

Në përvjetorin e vrasjes së tyre, kryeministri dhe kryetari i LV-së, Albin Kurti, me bashkëpunëtorë, kanë bërë homazhe para pllakës përkujtimore të Arben Xheladinit dhe Mon Balajt në bulevardin "Nëna Terezë" në Prishtinë.

Kurti në fjalën e tij ka theksuar se dhjetëra mijëra qytetarë demonstruan para 16 vjetëve e në ballë të tyre ishte baca Adem Demaçi në moshën 71-vjeçare. "232 plumba gjithsej u shkrepën në trupat dhe kokat e qytetarëve nga policia e UNMIK-ut në një situatë ku asgjë s'shihej prej gazit të shumtë lotsjellës. Arben Xheladini dhe Mon Balaj u vranë, kurse 80 demonstrues të tjerë u plagosën rëndë e lehtë. Hysni Hyseni Doda e humbi syrin, Mustafë Nerjova e ka ende sot një

pjesë plastike në kafkën e kokës, kurse Zenel Zeneli e mban plumbin akoma afër zemrës sepse nuk do të arrinte t'i mbijetonte operacionit kirurgjik. Doda i Prizrenit ka vdekur para tri vjetëve, kurse Zenel Zeneli dhe Mustafë Nerjova janë këtu sot me ne", ka deklaruar Kurti, duke shtuar se ish-shefi i shtyllës së parë të UNMIK-ut, Robert Dean, pati bërë një hetim atë pranverë nga i cili doli konkluzioni që për menaxhimin e asaj demonstrate vrasjet e Monit dhe Arbenit kanë qenë edhe të panevojshme edhe të evitueshme. "Policët e UNMIK-ut shfrytëzuan imunitetin ndërkombëtar, ndërkaq sekretari i përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka ngelur t'i përgjigjet ministrisë sonë të Drejtësisë. Një javë para demonstratës sonë u pat publikuar Paketa e Ahtisaarit, ndërkaq 6 javë pas asaj demonstrate Ahtisaari e shtoi rekomandimin për pavarësi të mbikëqyrtur si faqe të parë të propozimit të tij. Të dashur qytetarë, kurrë nuk ka qenë më e diskutueshme gjithandej, nëse ia kanë vlejtur komunat mbi baza



etnike. Prandaj Beogradi zyrtar me kaq nervozë kërkon asociacion. Si 'Zajednicë' komunash pat nisur edhe Republika Srpska në Bosnjë-Hercegovinë. Jam i bindur që këtë nuk e duan serbët e Kosovës, por jam i bindur që mu këtë e do Serbia", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se Kosova ka nevojë për më shumë demokraci e ndër aspektet e rëndësishme të demokracisë është pluralizmi politik. "Te komuniteti serb në Kosovë njëmend nuk ka pluralizëm politik. Mirëpo ai, megjithatë, po lind me qeverisjen tonë demokratike e progresiste. Prandaj Serbia është në panik. Duan që t'i bëjnë bashkë sa më

parë 10 kryetarë komunash të së njëjtës parti që i dirigojnë ata, ta shpallin një president zajednice dhe me atë ta shkulin ministrin tonë të qeverisë tonë, ministrin nga radhët e komunitetit serb. E padrejtë dhe e gabueshme, e dëmshme dhe e papranueshme", ka thënë Kurti.

Kurti bashkë me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, kryetarin e Podujevës, Shpejtim Bulliqi, familjarë e miq të Monit dhe Arbenit, ministra, anëtarë të kryesisë dhe deputetë e aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë bërë homazhe edhe te varri i Mon Balajt në Podujevë dhe te varri i Arben Xheladinit në

Prishtinë. "16 vjet më parë, 10 shkurt 2007, Arben Xheladini dhe Mon Balaj, krahas mijëra demonstruesve të tjerë që po kundërshtonin në formë të marshimit paqësor padrejtësitë e Pakos së Ahtisaarit, u qëlluan nga policia rumune e UNMIK-ut që, siç edhe dëshmuar përplot raporte të organizatave që merren me të drejta të njeriut, përfshirë vetë Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut (2 mars 2015), kishte përdorur forcë absolutisht të panevojshme për t'i shpërndarë demonstruesit. 16 vjet më vonë ende nuk ka drejtësi për Arben Xheladinit dhe Mon Balajt", është theksuar në njoftimin e LV-së.



## Marty: Qëllimi i atyre që më kërcënuan nuk ishte të më vritnin, por t'ua linin fajin shqiptarëve



PRISHTINË, 10 SHKURT - Ish-raportuesi i Këshillit të Evropës, Dick Marty, i cili ka qenë nën mbrojtje speciale për dy vjet për shkak të kërcënimeve me vdekje që mori, thotë se është i zhgënjyer me autoritetet zvicerane. Marti, në një intervistë për të përditshmen e shërbimit publik zviceran RTS, i pyetur se si ndihet, është përgjigjur duke e konsideruar atë që po ndodh në botë, i privilegjuar. "Sa i përket policisë, ka marrë masa për të më mbrojtur, por jam i zhgënjyer dhe nuk i kuptoj metodat e hetimit të autoriteteve zvicerane për rastin tim. Kam kohë që jam hetues dhe nuk dua të ndaj mësim, por më duket se metodat e përdorura në rastet e mia nuk janë të zakonshme", theksoi Marti. Pas kësaj pasuan kërcënimet, dhe Marti thotë se qëllimi i atyre që e

kërcënuan nuk ishte ta vritnin, "por t'ua vendosnin përgjegjësinë shqiptarëve nga Kosova". "Kur autoritetet zvicerane tashmë e kishin atë informacion, pse nuk u thanë serbëve se e dinin se çfarë po ndodhte dhe u kërkuan që të rregullonin gjithçka në shtëpi, me kërcënimin se në të kundërt do të shpërthente një skandal. Pastaj qëllimi vrasja ime dhe vënia e përgjegjësisë mbi shqiptarët nga Kosova, nuk do të kishte më kuptim", beson Marti.

Ai theksoi se nuk ka kuptim vetëm të mbrohet objektivi, por është, gjithashtu e nevojshme, të merren masa, prandaj ai nuk e kupton se vetëm pas tetë apo dhjetë muajsh që kur ka marrë kërcënimet, është nisur një hetim dhe vetëm pas 16 muajsh delegacioni i "FedPol" u dërgua në Beograd.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI (IKD) KA PARAQITUR RAPORTIN ME TITULL “PLANIFIKIMI (JO)ADEKUAT I QEVERISË”

## Qeveria s'ka arritur t'i miratojë as gjysmën e projektligjeve të planifikuara për vitin 2022

Në raportin me titull “Planifikimi (jo)adekuat i qeverisë”, i paraqitur të premten nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), u theksua se Qeveria e Kosovës nuk ka arritur t'i miratojë as gjysmën e projektligjeve të planifikuara për vitin 2022. Autori i këtij hulumtimi, Naim Jakaj, ka thënë se qeveria ka miratuar 71 nga 171 projektligjet e planifikuara. Sipas tij, nga 71 projektligjet e miratuara, 39 janë miratuar sipas planifikimit, ndërsa 32 projektligje janë miratuar duke mos e respektuar afatin e planifikuar

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka paraqitur raportin me titull “Planifikimi (jo)adekuat i qeverisë”, i cili është rezultat i monitorimit të drejtpërdrejtë dhe sistematik që IKD i ka bërë Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me përmbushjen e programit legjislativ për vitin 2022. Sipas IKD-së, Qeveria e Kosovës ka miratuar gjithsej 21 koncept-dokumente nga 71 sa kishte planifikuar, apo më pak se 30 për qind të planifikimeve deri në fund të vitit 2022.

Autori i këtij hulumtimi, Naim Jakaj, ka thënë se, pavarësisht prej ndryshimeve të shpeshta në programin legjislativ, nuk janë miratuar as gjysma e projektligjeve të planifikuara. “Deri në fund të vitit 2022 Qeveria e Kosovës ka miratuar gjithsej 21

koncept-dokumente nga 71 sa kishte planifikuar, apo më pak se 30 për qind të planifikimeve. Në gjashtë raste, IKD-ja ka gjetur se me rastin e draftimit të këtyre dokumenteve nuk janë respektuar obligimet lidhur me konsultimet publike”, ka thënë ai.

Jakaj ka theksuar se në mungesë të një planifikimi adekuat, po gjatë vitit 2022 qeveria e ndryshoi dhe plotësoi programin legjislativ plot nëntë herë. “Kështu, gjatë vitit 2022 qeveria pati më tepër plan mujor sesa vjetor. Përkundër ndryshimeve të shpeshta, qeveria gjatë vitit 2022 nuk ka arritur të miratojë as gjysmën e projektligjeve të planifikuara, duke përmbushur agjendën legjislativë vetëm 41.5 për qind, përkatësisht duke miratuar 71 nga 171 projektligjet e planifikuara. Nga 71 projektligjet e miratuara, 39 janë miratuar sipas planifikimit, ndërsa 32 projektligje janë miratuar duke mos e respektuar afatin e planifikuar.



Ndërsa përkundër faktit se qeveria ndryshoi plot nëntë herë agjendën legjislativë, të cilën e përmbushi vetëm 41.5 për qind, në tri raste ajo e injoroi këtë agjendë, duke miratuar projektligje të paplanifikuara”, ka thënë Jakaj.

Sipas tij, nga 71 projektligjet e miratuara në qeveri, IKD-ja ka gjetur se 48 prej tyre është dashur t'i nënshtrohen procesit të konsultimit publik, derisa ky obligim nuk ka vlejtur në raport me 23 projektligje që kanë të bëjnë me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. “Nga 48 projektligjet për të cilat qeveria ka

qenë e obliguar të zhvillojë konsultime publike, qeveria e ka përmbushur këtë detyrim në 29 raste, derisa këtë nuk e ka bërë në 19 raste të tjera. Shprehur në përqindje, qeveria nuk e ka përmbushur këtë obligim në afërsisht 40 për qind të rasteve”, ka deklaruar Jakaj.

Ai pati vërejtje edhe në miratim të projektligjeve nga Kuvendi. Jakaj ka bërë me dije se vetëm 21 për qind e tyre janë miratuar në shqyrtim të dytë. “Krahasimisht me numrin e projektligjeve që qeveria ka planifikuar të miratojë, Kuvendi ka miratuar në shqyrtim të dytë vetëm 21.05 për qind të

tyre. Kështu, pjesa tjetër e projektligjeve të miratuara në qeveri të cilat nuk janë miratuar nga Kuvendi, konsiderohen të përfunduara në qeveri, por se miratimi i tyre nuk ka ndodhur ende. Në anën tjetër, gjatë vitit 2022 IKD-ja ka gjetur se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka respektuar Kushtetutën me rastin e miratimit të ligjeve në qeveri. Fatkeqësisht, disa nga këto projektligje edhe janë miratuar në Kuvend, ndërsa disa të tjera janë duke u trajtuar nga institucionet e tjera, si Avokati i Popullit apo Gjykata Kushtetuese”, ka thënë Jakaj.

## Çollaku për planin franko-gjerman: Në thelb të tij është asociacioni, e jo njohja reciproke

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Kryeministri Albin Kurti në fillim të kësaj jave ka deklaruar se në takimin me emisarin special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, e ka pranuar propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Kurti është shprehur se propozimi evropian është një bazë e mirë për diskutime në të ardhmen dhe një platformë e mirë për të ecur tutje.

Në lidhje me pranimin e planit evropian nga ana e Kosovës, njohësi i çështjeve politike, Bekim Çollaku, për “Klankosova.tv” ka thënë se i njëjti nuk e përmban në thelb njohjen reciproke de jure dhe si, rrjedhojë, sipas tij, plani evropian nuk mund të konsiderohet se i përmbush synimet dhe pritjet e Kosovës për një marrëveshje përfundimtare dhe ligjërish të obligueshme me Serbinë. “Kosova ndodhet para një akti të kryer sepse kryeministri



e ka pranuar planin evropian apo franko-gjerman, është i obliguar të kyçet në hartimin e planit zbatues, sepse mundësitë për të negociuar për këtë plan tani duket se kanë përfunduar. Mendoj se gabimi esencial është bërë qysh në fillim nga qeveria jonë e cila e ka pranuar këtë plan pa e lënë të hapur mundësinë për negociim

dhe përmirësim”, është shprehur Çollaku.

Ai ka thënë se në planin evropian është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe formalizimi i statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. “Në thelb të planit evropian është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në

Kosovë dhe formalizimi i statusit të Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Ndërsa njohja reciproke, fatkeqësisht, nuk është pjesë e planit”, ka thënë Çollaku.

Më tutje, Çollaku ka thënë se plani evropian do të mund të konsiderohej si bazë e mirë për t'i nisur negociatat me Serbinë mirëpo, sipas tij, nuk do të duhej të pranohej pa pasur mundësi për t'u përmirësuar. “Kryeministri udhëheq qeverinë e Kosovës dhe në vendimet e tij duhet ta reflektojë vullnetin politik të kabinetit të tij dhe mazhorancës parlamentare. Për më tepër, ai do të duhej të udhëhiqej nga interesi shtetëror dhe qytetar në vendimet e tij. I tillë siç është pranuar, ky plan ka shumë implikime të vështira për Kosovën, ka shumë pikëpyetje lidhur me garancitë ndërkombëtare dhe përfitimet eventuale. Ndërsa pika më e dobët e këtij plani është se nuk sigurohet marrëveshja

përfundimtare dhe as njohja reciproke”, është shprehur Çollaku.

Ish-ministri i Integritimit Evropian është shprehur se është dëshpërues diskursi ku nuk po përmendet marrëveshja finale me Serbinë si fazë e fundit e diskutimeve, pasi në mes ka hyrë plani evropian dhe, siç ka thënë, BE-ja është përcaktuar për një marrëveshje tjetër e cila, sipas tij, do të prodhojë një status quo të re. “Kjo situatë është dëshpëruese dhe reflekton më së miri gjendjen në të cilën ndodhet procesi i dialogut. Tani është e qartë se në mungesë të vullnetit politik të Kurtit dhe Vuçiqit për marrëveshje përfundimtare, ndërmjetësuesi i bisedimeve, pra BE-ja, është përcaktuar për një marrëveshje tjetër të radhës e cila do të prodhojë një status quo të re. Pra, nuk ka marrëveshje përfundimtare”, është shprehur Çollaku.

# Thaçi bën kërkesë urgjente, insiston që 9 dëshmitarët pro tij të thirren në gjyq qysh në mars

HAGË, 10 SHKURT - Mbrojtja e ish-presidentit Hashim Thaçi në Hagë po vazhdon të insistojë që nëntë dëshmitarë të saj të dëgjohen para se të nisë çështja e prokurorisë në Gjykatën Speciale. Në një parashitje, mbrojtja e Thaçit, udhëhequr nga avokati Gregory Keohe, ka listuar arsyet pse po e kërkon një gjë të tillë.

Faktorët kryesorë pse kjo kërkesë duhet të pranohet, sipas mbrojtjes, janë mosha e shtyrë e dëshmitarëve si dhe koha e parashikuar kur do ta fillojë çështjen e saj. Në këtë kontekst, sipas avokatit Keohe, ekziston rreziku që dëshmitarët të mos jenë gjallë kur gjykimi është në fazën e paraqitjes së çështjes së mbrojtjes. "Mbrojtja pohon se dëshmitarët do të ofrojnë disa nga provat më të rëndësishme që Gjykata Speciale do të dëgjojë në këtë rast, ndër të tjera, për shkak të: (1) pozitës dhe roleve të tyre në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës; (2) përparësi unike dhe përfshirje me

individë kyçë gjatë asaj kohe; (3) ndërveprimet me z. Thaçi në nivel profesional dhe në disa raste personal; dhe (4) aftësia për të dëshmuar rreth çështjeve thelbësore për çështjen. Mbrojtja pohon se mocioni është i justifikuar në dritën e dy faktorëve: (i) mosha e shtyrë e dëshmitarëve dhe (ii) koha e parashikuar kur mbrojtja është e mundshme për të filluar në dritën e parashikimeve aktuale, d.m.th. fundi i vitit 2025 ose fillimi i vitit 2026. Mbrojtja argumenton se këta faktorë janë të rëndësishëm në përcaktimin nëse është i garantuar një mekanizëm për t'i ruajtur provat që, përndryshe, mund të jenë të padisponueshme. Ajo parashtron se në kohën kur çështja e Mbrojtjes fillon, atje është një rrezik shumë real që provat e dëshmitarëve të cilët më pas do të jenë në të 80-at mund të mos jenë më të disponueshme për shkak të vdekjes ose paaftësisë. Mbrojtja pretendon se mocioni është mjeti i fundit për ta shmangur rrezikun e

humbjes së ndonjërit prej dëshmitarëve. Ai pohon se rregullat 153-155 janë të papërshtatshme. Ai argumenton se nuk i shkaktohet asnjë paragjykim prokurorisë pasi çdo shqetësim, nëse ekziston, mund të kurohet nga aftësia e prokurorisë për të bërë pyetje kryesore për marrje në pyetje", është thënë në parashitjen e shpjeguar nga trupi gjyqës.

Mbrojtja e Thaçit ka kërkuar që dëshmitarët e saj, që gjithsej janë nëntë në moshë të shtyrë, të dëgjohehen në sallën e gjyqit gjatë muajit të ardhshëm. Një prej tyre, mbrojtja, ka thënë se është i gatshëm që dëshminë e tij ta japë në prill. "Sa i përket procedurës së ndihmës parësore, mbrojtja kërkon që dëshmitarët të dëgjohen në sallën e gjyqit të Gjykatës Speciale në mars 2023, por për një që është i disponueshëm vetëm që nga prilli 2023. Sa i përket ndihmës alternative, ajo kërkon që depozitimet të kryhen në seancë të hapur në sallën e gjyqit të Gjykatës Speciale

nëse dëshmitarët janë mjaftueshëm mirë për të udhëtuar në shkurt 2023, me përjashtim të një dëshmitari të disponueshëm në prill 2023. Mbrojtja vlerëson se zbatimi i njërit prej lehtësirave të kërkuara do të zgjasë deri në dy ditë, që përbëhet nga një ekzaminim i përgjithshëm nga Mbrojtja, një marrje në pyetje e mundshme nga ekipet e tjera të mbrojtjes dhe Prokuroria, së bashku me pyetjet nga avokati i viktimave dhe paneli, nëse ka", është thënë në parashitjen e Keohe, raporton "lajmi.net".

Kjo kërkesë, sipas avokatit të Thaçit, do të nënkuptonte një ndryshim të rendit të marrjes në pyetje të dëshmitarëve. Sipas tij, kjo është e drejtë e garantuar e të akuzuarit dhe në këtë rast duhet të pranohet. "Mbrojtja kërkon t'i ruajë provat e nëntë dëshmitarëve ('dëshmitarët') për të garantuar, sipas saj, të drejtën e Thaçit për ta marrë pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër

të tij, në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij. Për ta bërë këtë, mbrojtja i kërkon panelit që ta ndryshojë rendin e zakonshëm të provave, siç parashikohet në Rregullën 127, në mënyrë që t'i dëgjojë dëshmitë e dëshmitarëve përpara fillimit të çështjes së prokurorisë, në vend që pas përfundimit të saj ('ndihma parësore'). Në alternativë, mbrojtja fton panelin ta sigurojë dëshminë e dëshmitarëve duke vëzhguar marrjen e depozitave sipas Rregullit 100 ('lëshimi alternativ'). Mbrojtja pohon se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara e fuqizon panelin për të miratuar një kërkesë për ruajtjen e provave nëpërmjet depozitimeve, nëse ka arsye për të besuar se provat e një dëshmitari të mundshëm përndryshe mund të bëhen të padisponueshme", është thënë në fund të kësaj shkrese.

Gjyqi ndaj krerëve të UÇK-së pritet të nisë në fillim të muajit të ardhshëm.



## Vazhdon shtrirja e projektit “Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë”

DRENAS, 10 SHKURT - Ka vazhduar shtrirja e projektit “Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë” nga zyra e BE-së për Arsim në Kosovë, implementuar nga organizata DAI dhe KosEd në komunën e Drenasit. Roli kryesor i këtij projekti është mbledhja e dëshmimeve që mbështetin dokumentin e vetëvlerësimit

dhe çojnë në rekomandime konstruktive që do ta përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në shkollë. Ekspertët e jashtëm të fushës së arsimit në zyrën e BE-së për arsim në Kosovë e kanë vlerësuar lart shtrirjen dhe implementimin e projektit nga komuna e Drenasit, e cila do të

jetë model për komunat e tjera të Kosovës. “I gjithë angazhimi ynë do të jetë në shërbim të ngritjes së cilësisë së arsimit në komunën e Drenasit, duke u angazhuar kështu në secilin iniciativë që ndihmon këtë rritje, në secilin projekt që zhvillon sektorin e arsimit në komunën tonë”, ka njoftuar komuna e Drenasit.



## Haxhiu i kërkon prokurorit të tërhiqet nga aktakuza për gazin lotsjellës: Dorëzohu, s’është vonë



PRISHTINË, 10 SHKURT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, i ka bërë thirrje prokurorit Ilaz Beqiri që të dorëzohet dhe të tërhiqet nga aktakuza pasi mungon ekspertiza dhe faktet për gazin lotsjellës.

Thirrja e Haxhiut drejtuar prokurorit është bërë të premtën në seancën gjyqësore ku ajo bashkë me deputetin Pal Lekaj dhe ish-deputetet Donika Kadaj-Bujupi e Besa Baftiu akuzohen se më 19 shkurt 2016 kanë poseduar jashtëligjshëm në Parlament

nga një bombol të gazit. “Prandaj, ndonëse pas shtatë vjetësh, i kërkoj prokurorit që të dorëzohet, të tërhiqet nga aktakuza. Nuk është vonë asnjëherë për të bërë një veprim të tillë”, ka deklaruar Haxhiu.

Kërkesa e Haxhiut ka ardhur pasi është vendosur të kërkohej ekspertizë balistike jashtë Kosovës për të vërtetuar se çfarë mjetesh kanë pasur të akuzuar.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se pa një

ekspertizë të tillë nuk mund të ftohen, gjykohej e dënohen. “Konsideroj se ekspertiza në këtë proces gjyqësor është shumë e rëndësishme, pra është thelbi i çështjes dhe konsideroj se nuk mund të ftohen, gjykohej, dënohen personat pa një ekspertizë të tillë. Pra, nuk mund të gjykohej personat me interpretime të prokurorit, duhet të ketë prova, duhet të ketë fakte, duhet të ketë ekspertizë”, ka shtuar ajo, raporton “Betimi për Drejtësi”.

## Bulliqi dhe Vitia vizituan ambulanten e re të mjekësisë familjare në Gllamnik

PODUJEVË, 10 SHKURT - Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me nënkryetaren Marigona Lahu, drejtoreshën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Adelinë Stublla, zhvilluan takim me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, me të cilin diskutuan për projektet kapitale në sektorin e shëndetësisë në komunën e Podujevës. Gjatë takimit si synime kryesore për këtë vit u diskutuan: Funkcionalizimi i shërbimeve specialiste në

objektin pranë shkollës “Enver Maloku”, ofrimin e shërbimeve të hemodializës në komunën e Podujevës dhe ndërtimi i Qendrës Rezidenciale për Persona të Moshuar.

Pas takimit vizituan Ambulanten e Mjekësisë Familjare në Gllamnik, objekt i cili është ndërtuar nga bashkëfinancimi i bërë nga komuna me “Qatar Charity”.

Kryetari Bulliqi gjatë vizitës ka thënë ky objekt modern shëndetësor është furnizuar

me të gjitha pajisjet e nevojshme që e bën një prej objekteve më të bukura dhe më funksionale në sektorin e shëndetësisë në Podujevë.

Po ashtu, Bulliqi dhe ministri Vitia vizituan hapësirat e objektit të destinuar për shërbime specialiste në qytet dhe punimet që po zhvillohen në ndërtimin e Urgjencës së Qytetit.

Bulliqi ka falënderuar ministrin Vitia për vizitën dhe gatishmërinë për mbështetje.



## Abdixhiku: Kosova ta trajtojë me urgjencë ikjen e stafit shëndetësor



PRISHTINË, 10 SHKURT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, është takuar të premtën me studentët të Fakultetit të Mjekësisë. Përmes një postimi në “Facebook”, Abdixhiku ka bërë me dije se gjatë takimit kanë folur për kushtet e studentëve dhe pritjet për të ardhmen. Në këtë kontekst, ai ka thënë se

studentët meritojnë një shtet që u jep të ardhme të mirë. “Këtë mëngjes takova studentët e Fakultetit të Mjekësisë. Secili me përkushtim të dalluar në rrugën profesionale që ndjekin. Folëm për kushtet e tyre sot e pritjet e tyre për nesër. Ikja e stafit shëndetësor nga Kosova është bërë problem kombëtar yni. Këtë problem Kosova duhet ta

trajtojë me urgjencë. Paga më të larta, sigurime shëndetësore sa më parë, e investime kapitale në nivel dyfish më të lartë, mbesin zgjidhje të pazëvendësueshme sot. Të tillët si këta që i takova, meritojnë një shtet që u jep të ardhme të mirë. Kosova i meriton si gjeneratë në ardhje në shëndetësi”, ka shkruar Abdixhiku.

## Kryetari i Malishevës priti në takim përfaqësues të organizatës “Flutura Academy”

MALISHEVË, 10 SHKURT - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, bashkë me nënkryetarin Vesel Krasniqi dhe drejtoreshën e Arsimit, Arbëreshë Krasniqi, kanë pritur në takim përfaqësues të organizatës “Flutura Academy”, të drejtuar nga Valdete Bajrami. Në

këtë takim temë kryesore e diskutimit ka qenë bashkëpunimi i mundshëm i komunës së Malishevës me organizatën “Flutura Academy” dhe për mundësinë që kjo organizatë ta shtrijë veprimtarinë e saj edhe në territorin e komunës së

Malishevës.

Kryetari Kastrati u shpreh tejet i gatshëm për të përkrahur një nismë të tillë, me qëllim që fëmijët e komunës sonë të mund të marrin njohuri shtesë në fushën e IT-së, kryesisht në programim, por edhe në programe të gjuhës

angleze dhe gjermane.

Edhe Valdete Bajrami nga kjo organizatë e falënderoi kryetarin Kastrati dhe në përgjithësi komunën e Malishevës për takimin dhe vullnetin e treguar në funksion të jetësimit të kësaj nisme edhe në Malishevë.



# Kontratat kolektive 'gjunjëzojnë' komunat



**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Dhjetëra milionë euro llogaritet të jetë dëmi financiar i shkaktuar nga mospërmbushja e kontratave kolektive kundrejt punonjësve të arsimit në Kosovë. Nga viti 2014 janë nënshkruar tri kontrata të tilla ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sindikatës së Arsimit, por ato nuk janë zbatuar kurrë plotësisht. Për pasojë, shumë punonjës të arsimit, që do të duhej të përfitonin prej tyre, kanë ngritur padi në gjykata, shumë prej të cilave janë përmblyllur në favor të tyre. Zyrtarët e komunave ankohen se kompensimi i punonjësve u ka shkaktuar atyre telashe të mëdha financiare.

## Çfarë është kontrata kolektive?

Kontrata kolektive parasheh disa përfitime financiare për punonjësit e arsimit - nga pagesa për shujtat ushqimore apo për shpenzimet e udhëtimit deri te paga shtesë pas pensionimit. Me ligj, këto përfitime duhet të paguhen nga komunat, të cilat janë punëdhënëse të punëtorëve të arsimit. Por, qeveritë e deritashme qendrore nuk u kanë dhënë atyre buxhet shtesë për këtë qëllim. Kështu, punonjësit që nuk kanë përfituar u janë drejtuar gjykatave, dhe kur rasti është përmblyllur në favor të tyre, ata

kanë arritur ta nxjerrin kompensimin nga buxheti i komunës.

Istref Atashi, nga fshati Leshan i Pejës, është pensionuar në nëntor të vitit 2015, pas 44 vjetësh përvojë pune në Shkollën Filllore "Zef Serembe". Asokohe ka qenë në fuqi kontrata e parë kolektive me mësimdhënësit, por as Atashi, as kolegë të tij të pensionuar nuk kanë marrë pagat shtesë që u kanë takuar për çdo dekadë që kanë kaluar në punë. "Kemi bërë kërkesë në Drejtori të Arsimit - diku 69 kemi qenë që jemi pensionuar brenda vitit. [Na kanë thënë] ju takojnë, por buxhet nuk kemi", tregon Atashi për "Radion Evropa e Lirë".

Përmes një avokati të siguruar nga Sindikata e Arsimit, këta mësimdhënës kanë ngritur padi kundër komunës në gjykatë. Komuna është ankuar dy herë kundër kësaj procedure, por vendimi final është marrë në favor të Atashit dhe të tjerëve në fund të vitit 2022. Atashi tash pret ta marrë kompensimin nga komuna, që kap vlerën e rreth 3 000 eurove. "E ndiejmë veten keq. Është procedurë shumë e ngarkuar", thotë ai, duke treguar se disa kolegë të tij kanë vdekur pa i marrë paratë që u takonin.

## Komuna e Pejës, katër milionë euro borxhe

Zyrtarë të komunës së Pejës thonë se kontratat kolektive

kanë shkaktuar probleme shumë të mëdha financiare për këtë komunë.

Fisnik Imami, zyrtar ligjor në komunën e Pejës, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ky institucion ka rreth 4 milionë euro borxhe si pasojë e padive të mësimdhënësve. Komuna, sipas tij, aktualisht përballet me rreth 1 200 padi për kompensimin e shujtave ushqimore - në vlerë prej dy eurosh në ditë - për mësimdhënësit.

Peja, sipas statistikave zyrtare, ka rreth 1 300 mësimdhënës. Imami thotë se paditë, tash për tash, kanë të bëjnë me dy kontratat e para kolektive, ndërsa për të tretën pritet të vijë në vazhdim. "Kontrata kolektive e ka lënë komunën në gjunjë. Krejt çka ka në kontratë, po u aprovohet [në gjykatë], sepse iu takon. Mirë apo keq, iu takon", thotë Imami.

Kontrata e fundit kolektive, e nënshkruar në vitin 2021, është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Ministria e Arsimit në nëntor të vitit të kaluar, me arsyetimin se nuk është menaxhuar siç duhet. "Kjo kontratë ka pasur probleme serioze ligjore dhe, si e tillë, është e pavlefshme. Për këtë kontratë nuk ka pasur asnjë vlerësim ligjor, financiar dhe planifikim buxhetor para nënshkrimit", thanë nga Ministria e Arsimit përmes një deklaratë dërguar "Radios Evropa e Lirë". Sipas Ministrisë, efekti i

kontratës do të ndalojë nga dita e shkëputjes dhe nuk do të ketë mundësi për kompensim retroaktiv. Ministria, po ashtu, tha se do të nënshkruajë kontratë të re kolektive pas negociatave me Sindikatën e Arsimit. "Çdo kontratë që do të nënshkruajë Ministria në të ardhmen do të bazohet në ligjet në fuqi, për t'i mënjeluar situatat e tilla që kanë ndodhur në të kaluarën", tha ministria në deklaratën me shkrim.

## "Kontrata kolektive, ende në fuqi"

Por, Rrahman Jashari, kryetar i Sindikatës së Arsimit, thotë se shkëputja e njëanshme e kontratës kolektive nga qeveria është joligjore. Për këtë sindikatë, ajo vazhdon të jetë në fuqi. "Të gjitha kërkesat dhe të drejtat që janë aty [në kontratë kolektive], ose do t'i arrijmë përmes diskutimeve me nivelin komunal, sepse ai është punëdhënësi, ose mësimdhënësit do të vazhdojnë t'i dërgojnë rastet në gjykata, të cilat deri më tani i kemi fituar të gjitha", thotë Jashari për "Radion Evropa e Lirë". Me kompensimin e mësimdhënësve janë përballur të gjitha komunat e Kosovës, përveç dhjetë komunave me shumicë serbe, të cilat nuk janë pjesë e Sindikatës së Arsimit të

Kosovës, pasi ato punojnë me planprograme të Serbisë.

Ajo e Gjakovës, për shembull, ka shpenzuar mbi 2.5 milionë euro në katër vjetët e fundit për t'i paguar kompensimet që mësimdhënësit i kanë fituar me padi. "Kjo situatë e rrezikon buxhetin, sepse prishen planifikimet buxhetore në të gjitha kategoritë ekonomike, si: mallrat, pagat, investimet kapitale, dhe nuk mund të realizohen projekte të ndryshme të investimeve në komunën e Gjakovës", thonë nga kjo komunë për "Radion Evropa e Lirë".

Kostoja e saktë e padive të ngritura në komuna nuk është e qartë meqë ato janë në faza të ndryshme. Në një deklaratë dhënë REL-it në gusht të vitit të kaluar, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka thënë se kjo kosto mund të sillet në rreth 35 milionë euro. Në koordinim me këtë asociacion, komunat kanë ngritur padi ndaj Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar kthimin e mjeteve të shpenzuara gjatë kompensimit të mësimdhënësve, por këto padi, deri më tani, nuk janë trajtuar në gjykata.

Në dhjetor të vitit të kaluar Kuvendi i Kosovës ka miratuar buxhetin e shtetit në vlerë prej 3.2 miliardë eurosh. Prej tyre, rreth 660 milionë i dedikohen qeverisjes lokale dhe komunave.

# Kuvendi miraton vlerën e koeficientit të pagave



**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Me 63 vota për, Kuvendi i Kosovës ka miratuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Kosovës për vitin 2023. Me këtë është miratuar edhe propozimi i Qeverisë së Kosovës për vlerën monetare të koeficientit prej 105 eurosh.

Buxheti i përgjithshëm për paga në sektorin publik për vitin 2023 do të jetë 745 milionë euro. Me Ligjin e ri për Paga, niveli i koeficienteve është nga 2 deri në 18. Presidentes së shtetit i është caktuar koeficienti më i lartë, sipas të cilit, ajo do të ketë pagën më të madhe.

Ligji për Paga zbatohet për punonjësit e sektorit publik, pagat e të cilëve financohen nga buxheti i shtetit, me përjashtim të punëtorëve të Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI).

Janë rreth 83 mijë punonjës të sektorit publik që marrin pagë nga buxheti i shtetit.

Gjatë seancës parlamentare

ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se shumica e tërësishme e kufirit për kategorinë e pagave, nëse krahasohet me shpenzimin e vitit paraprak, është rritur në vlerë prej 105 milionë euro. Sipas tij, rritje të tillë nuk ka pasur asnjëherë.

Me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, i cili përcakton edhe vlerën e koeficientit, janë pajtuar deputet e Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Armend Muja, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se me rritjen e koeficientit parashihet që paga mesatare bruto në sektorin publik të jetë 730 euro në muaj apo 18 për qind rritje krahasuar me vitin paraprak.

Me koeficientet e rinj ai tha se është krijuar një barazi në mesin e shërbyesve publikë. “Një çështje tensioni te pagat në sektorin publik ka qenë raportori disproporcional ndërmjet pagës më të lartë dhe asaj më të ulët. Sipas të

dhënave që i kemi për vitin e kaluar, paga më e lartë në sektorin publik ka qenë e drejtorit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në vlerë 5 325 euro, kurse më e ulëta ajo e shtëpiakut të shkollës filllore 242 euro. Me propozimin-ndryshimin e ligjit është që ngushtohet ky dallim me 1-5. Rroga më e lartë parashihet të arrijë në 1 890 euro, më e vogla rreth 395 euro”, tha Muja.

Ai tha se Ligji për Paga nuk parash zvogëlim të pagave për asnjë kategori për vitin e parë për shkak të propozimit të shtesës tranzitore. Deputetët e partive opozitare kanë kundërshtuar vlerën e koeficientit pasi që, sipas tyre, është i ulët.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, tha se në krizën më të madhe ekonomike dhe sociale qeveria ka thyer premtimin për të ndihmuar njerëz të zakonshëm në rritjen e koston së jetesës. “Shporta bazë e konsumatorit - jo produktet e luksit, por produktet që janë të

domosdoshme - janë ngritur deri në 50 për qind”, tha Bajrami.

Ajo e kritikoi Qeverinë e Kosovës se me këtë Ligj të Pagave është prekur edhe sektori i drejtësisë që, sipas saj, konsiderohet ndërhyrje e drejtpërdrejtë nga ana e ekzekutivit. Kosova e ka mbyllur vitin 2022 me një normë mesatare inflacioni prej 11.6-përqindësh.

Rritje kanë pësuar çmimet e pothuajse të gjitha produkteve ushqimore dhe shërbimeve.

Deputeti nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Ferat Shala, tha se koeficienti prej 105-eurosh nuk përbën rritje reale, por rritje numrash. Shala tha se grupi parlamentar i PDK-së nuk pajtohet me këtë koeficient. “Nuk do të kemi rritje sepse përfituesit do ta shohin atë kur të fillojë shpërndarja e tyre. Kërkojmë që minimumi i kësaj të jetë 120 e më shumë në të kundërtën do të kemi shkallë të lartë të pakënaqësive dhe ankesave sepse këtu goditet një pjesë e

mirë e sektorit të drejtësisë, sektori i sigurisë pothuajse në të gjitha nivelet”, tha ai.

Pritjet e sindikatave të punëtorëve kanë qenë që kjo vlerë të mos jetë nën 120 euro.

Me vlerën monetare të koeficientit prej 105 eurosh ata janë shprehur të zhgënjyer.

Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e Kosovës (SBASHK) kanë thënë se paga që del me vlerën e re të koeficientit nuk i plotëson as pritjet, as nevojat e punonjësve të arsimit.

Në adresë të Avokatit të Popullit në Kosovë kanë arritur ankesa të shumta mbi për Ligjin e ri të Pagave, i cili ka hyrë në fuqi më 5 shkurt.

Avokati i Popullit në Kosovë, Naim Qelaj, i pati thënë Radios Evropa e Lirë se këto ankesa janë duke i trajtuar, por ende nuk kanë ndonjë përgjigje. “Nëse vlerësojmë se ka probleme [në ligj], ne kemi afat ligjor prej gjashtë muajsh për ta dërguar ligjin në Gjykatën Kushtetuese”, kishte deklaruar ai.

## Rritet për 19 për qind çmimi i arit gjatë muajve të fundit

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Nga data 3 nëntor i vitit të kaluar e deri me sot çmimi i arit është rritur mbi 19 për qind. Megjithatë tregtarët e arit e dinë se paqëndrueshmëria aktuale e tregut është një avantazh për çmimin e arit, kërkesa sezonale për ar po mbështetet gjithashtu në çmime më të larta.

Dy ngjarjet kryesore për tregtarët e arit janë Viti i Ri

Kinez, i cili filloi më 22 janar, dhe sezoni indian i dasmave që filloi në muajin dhjetor, por zgjat deri në fund të shkurtit. Kina është konsumatorja më e madhe në botë e arit dhe Viti i Ri Kinez është tradicionalisht një kohë kur shumë njerëz blejnë ar dhe kërkesa për të është e lartë.

India është konsumatorja e dytë më e madhe e arit në botë dhe sezoni i saj i dasmave, duke

përfshirë festivalin Diwali, shëh një rritje të madhe të kërkesës për ar, veçanërisht për bizhuteri.

Një tjetër faktor që mbështet çmimin e arit për momentin është dollari, i cili ka rënë vazhdimisht qëkur arriti kulmin në shtator të vitit të kaluar. Shumica e analistëve presin që dollari të vazhdojë të bjerë këtë vit.





# Një jetë pa pendesa



Bronnie Ware, një infermiere australiane, e cila kaloi disa vite duke u kujdesur për njerëzit gjatë javëve të fundit të jetës së tyre, pyeti në mënyrë rutinore pacientët për çdo pendesë që kishin, apo ndonjë gjë që do të bënin ndryshe nëse do të mundnin. Më vonë ajo postoi një artikull të quajtur “Pendemat e të vdekurve”. Në të, Ware shkroi për qartësinë fenomenale të vizionit që njerëzit kishin fituar në fund të jetës, si dhe për temat e zakonshme që u shfaqën vazhdimisht gjatë këtyre bisedave.

Ky artikull është shpërndarë miliona herë në internet dhe është kthyer në një libër në vitin 2012. Është një premisë magjepsëse, apo jo? Për çfarë pendohen më shumë njerëzit për jetën e tyre? Nuk do ta përfshij listën këtu. Në vend të kësaj, dua t’ju pyes: Sa fort doni të dini se çfarë ka në atë listë? Sa të tunduar jeni ta kërkonin në google artikullin në këto momente, në mënyrë që të mund të shihni pendesat kryesore që kanë njerëzit në fund të jetës së tyre? Dhe më e rëndësishmja, nga

vjen ajo dëshirë për të ditur pendesën e të vdekurve? A nuk është forca e interesit tuaj, prova se jeni të shqetësuar se mos jeta juaj shkon dëm?

Pse u bë virale një listë për pendesat e njerëzve të tjerë në prag të vdekjes? Kjo ndodh sepse të gjithë e dimë që një ditë do të jemi pranë vdekjes dhe nuk duam të pendohemi kur të arrijmë atje. Dhe gjithashtu, besoj, sepse që tani mund të kemi filluar të pendohemi për zgjedhjet tona të jetës.

Për njerëzit në moshën e mesme, dhe madje edhe për njerëzit në moshë madhore, është e zakonshme të kemi ankth të bezdisshëm se po harxhojmë kohën dhe burimet tona për gjëra që nuk janë të rëndësishme, ndërkohë që nuk fokusohemi mjaftueshëm në gjërat dhe njerëzit që kanë vërtet rëndësi. Dhe ne mund të imagjinojmë lehtësisht se do të na vjen keq për këtë një ditë, nëse nuk bëjmë një ndryshim. Megjithatë ne vazhdojmë, duke e vënë të parëndësishmen përpara

imperatives.

Diçka duhet të ndryshojë. Dhe nuk kemi shumë kohë përpara nesh.

Ne gjithmonë do të marrim disa vendime të pamendta gjatë rrugës, që do të dëshironim t’i zhbënim. Pra, ndoshta nuk është e mundur të jetosh një jetë pa absolutisht asnjë pendesë. Por me siguri është e mundur të bëjmë ndryshime që na largojnë nga rruga e kollajtë e zhytjes zhytur në të zakonshmen dhe të menjëhershmen dhe na fusin në një rrugë më të qëllimshme, e cila të çon drejt një jete që kënaq dhe jehon përtej ekzistencës sonë të vdekshme – një jetë e jetuar mirë. A nuk duam të gjithë një jetë me më pak pendesa dhe më shumë përmbushje?

## Si ta bëni jetën tuaj mjaftueshëm të gjatë

Në kolegji, kisha një profesor q më këshillonte: “Mendo të lexosh libra nga shekujt e mëparshëm, sepse të gjithë shkrimtarët e gjallë janë

duke notuar në të njëjtat rryma kulturore dhe ideologjike si ti. Por një libër nga shekuj më parë do të vijë nga një këndvështrim tjetër dhe do të sfidojë të menduarit tënd në mënyra të reja.”

Jam përpjekur të jetoj sipas kësaj këshille. Në fakt, shumë nga idetë e mia për Zotin, minimalizmin, të jetuarit me qëllim dhe tema të tjera që i kam për zemër janë informuar nga burra dhe gra të mençura të epokave të kaluara. Ata sjellin një perspektivë të re në një mënyrë që studiuesit apo ekspertët modernë nuk mund ta bëjnë. Dhe kam zbuluar se temat që bëjnë jehonë të përsëritur në periudha të ndryshme dhe në vende të ndryshme, janë shpesh tema që mund të na tregojnë ende rrugën drejt një jete më të mirë. Dhe duke patur këtë në mendje, dua të ndaj me ju një citim që e kam patur fort të rëndësishëm prej shumë vitesh tashmë. Është nga Seneka i Riu, një filozof romak i lindur në pothuaj të njëjtën kohë me Jezusin e Nazaretit:

“Nuk është se ne kemi pak kohë për të jetuar, por ne çojmë dëm

shumë nga kjo kohë. Jeta është mjaftueshëm e gjatë, dhe një sasi e madhe e saj na është dhënë për arritje nga më të mëdhatë, nëse ne e investojmë atë siç duhet.

Por, kur shpërdorohet në lukse të kota dhe shpenzohet për aktivitete pa vlerë, ne detyrohemi kur jemi në shtratin e vdekjes, që të kuptojmë se ajo na ka kaluar para syve pa e kuptuar që po ikën. Pra, nuk na është dhënë një jetë e shkurtër, por jemi ne që e shkurtojmë. Nuk kemi mungesë, thjesht e shpërdorojmë...”

Ky citim i guximshëm i Senekës është ai që kam parasysh kur i referohem një jete kuptimplote. Do të thotë të jetosh me një qëllim. Do të thotë ta harxhojmë kohën tonë për “arritje të mëdha”, në vend të “lukseve të kota” dhe “aktiviteteve pa vlerë”. Sepse nëse e bëjmë këtë, do të kuptojmë se jeta është mjaftueshëm e gjatë për gjërat që kanë më shumë rëndësi. / Shkëputur nga libri “Gjërat që kanë rëndësi”, me autor Joshua Becker – Në shqip nga bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Të dielën derbi Peja - Prishtina

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Java e 22-të në Prince Caffë Superligë do të dhurojë disa ndeshje mjaft interesante, kurse derbi do të zhvillohet ndërmjet Pejës dhe Sigal Prishtinës. Njëkohësisht kjo është xhiroja e fundit para "Final 8" e Kupës së Kosovës, që zhvillohet nga 15 deri më 19 shkurt në Rahovec. Pejanët kanë 14 fitore e shtatë humbje, kurse prishtinasit 16 fitore e pesë humbje, duke e bërë këtë sfidë edhe më interesante. Skuadrat kanë pasur formë të ndryshme, me "verdhezinjtë" që e nisën për mrekulli kampionatin, kurse "bardhekaltrit" nuk dinë për humbje në xhirot e fundit. Në takimet mes tyre në këtë edicion, pejanët fituan dy ndeshjet e para, kurse në të tretën fitoi bindshëm Prishtina 83:45. Takimi i parë i kësaj



xhiroje zhvillohet në Mitrovicë, ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë shtatë fitore e 14 humbje, ndërsa mitrovicasit 12 fitore e nëntë humbje, prandaj kjo sfidë është shumë e rëndësishme për të dyja skuadrat. Vëllaznimi -

Bashkimi, po ashtu, është takim interesant dhe i vlefshëm, ku kuqezinjtë ndodhen në vendin e gjashtë me tetë fitore e 13 humbje, ndërsa prizrenasit janë në vendin e pestë me nëntë fitore e 12 humbje. Java e 22-të mbyllet me përballjen mes

kampionit, Golden Eagle Yllit dhe Rahovecit. Therandasit numërojnë 16 fitore e pesë humbje, kurse Vreshtarët kanë dy fitore e 19 humbje, madje fitoren e parë e kishin arritur ndaj Yllit. Sidoqoftë, kampionët pas katër humbjeve kishin 15 fitore radhazi, duke u ndalur vetëm nga Trepça.

### Favoritët presin fitore

Të shtunën dhe të dielën zhvillohen tri ndeshjet e radhës që janë në kuadër të Superligës së Femrave. Java e 17-të hapet me ndeshjen mes Trepçës dhe Prishtinës, ku dy skuadrat vijnë me fitore nga xhiroja paraprake. Prishtina nga 16 lojë të zhvilluar ka 13 fitore e tri humbje, ndërsa Trepça ka pesë fitore dhe 11 humbje. Të dielën nga ora 13:00 Bashkimi pret në shtëpi United

Basketball. Prizrenaset kanë një ndeshje më pak të zhvilluar, por të gjithë ndeshjet e zhvilluar deri tani i ka fituar. Në anën tjetër United Basketball ka katër fitore e 12 humbje. Xhiro përmbyllet me ndeshjen Penza-Vëllaznimi, që zhvillohet të dielën nga ora 19:30. Penza ka nëntë fitore dhe gjashtë humbje, si dhe një ndeshje më pak të zhvilluar, ndërsa Vëllaznimi ka një fitore e 15-të humbje.

### SUPERLIGA - Java 22

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Ponte Prizreni - Trepça  
19:00 Vëllaznimi - Bashkimi

**Të dielën takohen:**  
17:00 Peja - Sigal Prishtina  
19:00 Golden Eagle Ylli - Rahoveci

## Donjeta Sadiku dhe Shpëtim Bajoku, më të mirët e vitit 2022 në boks

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Federata e Boksit e Kosovës (FboxK) ka organizuar ceremoninë për shpalljen e sportistëve më të mirë për vitin 2022. Padyshim që medalistja botërore dhe e bronzta e Kampionatit Evropian, Donjeta Sadiku, siguroi çmimin e boksieres më të mirë për vitin që e lamë pas. Ndërkaq, në konkurrencën e meshkujve çmimin e boksierit më të mirë e fitoi Shpëtim Bajoku. Po ashtu, në vazhden e shpërndarjes së çmimeve u dalluan edhe trajneri më i mirë, gjyqtari, punëtori sportiv dhe klubi më i mirë i vitit. Çmimin e trajnerit më të mirë e rrëmbeu Marjola Sallauka, kurse Latif Demolli u shpall gjyqtari më i mirë i vitit.



Punëtori sportiv më i dalluar ishte Nadir Shllaku, kurse klubi më i mirë i vitit u shpall K. B. "Gollaku". Po ashtu, çmime u ndanë edhe për

boksierët seniorë më të mirë, për boksierët e grupmoshave U18, U16 dhe U14, boksieret më të mira dhe për shpresat e boksit.



## Futbolli rikthehet me derbi

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Superliga e Kosovës në futboll rikthehet në aksion sot (e shtunë) pas një pauze të gjatë mes dy stinorëve. Java e 19 fillon me tri ndeshje mjaft interesante. Kampioni në fuqi i Kosovës, Ballkani, stinorin pranveror e nis në udhëtim te Malisheva, derisa Drenica përballlet me

Llapin, derisa Gjilani para tifozëve të vet ballafaqohet me Ferizajn. Kryesfida e kësaj fundjave luhet në Mitrovicë, ku Trepça '89 ballafaqohet me Dritën, ndërsa Prishtina pjesën e dytë të garave e nis në Klinë ku përballlet me Dukagjinin. Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 13:00.

## Besa sfidohet nga Vushtrria

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Në fundjavë luhen ndeshjet e xhiros së 16 në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Edhe kjo xhiro ofron ndeshje të mira dhe me rëndësi për renditjen në tabelë. Të shtunën janë tri ndeshje, ndërsa të dielën një. Të shtunën fokusi do të jetë në dy ndeshjet që zhvillohen prej orës 19:00. Në

Pejë, kampionia dhe liderja e klasifikimit, Besa Famgas, do të sfidohet nga Vushtrria. Vushtrria këtë edicion është kthyer në elitë, por ka pretendime të mëdha dhe do të synojë befasinë e madhe në Pejë. Besa natyrisht synon të vazhdojë me fitore. Besa udhëheq në tabelë me 25 pikë. Vushtrria është e gjashta me 14 pikë. Prej orës

19:00 është edhe përballja e rivalëve të mocëm, Kastriotit dhe Prishtinës. Pasi mori pikë në Rahovec, skuadra ferizajase synon fitoren ndaj Prishtinës. Ndërkohë prishtinasit udhëtojnë për dy pikë të reja dhe për ta vazhduar ecurinë pozitive. Prishtina në xhiron e 15 e mposhti Trepçën. Të shtunën prej orës 17:00 është

ndeshja Deçani - Llapi. Një tjetër ndeshje e rëndësishme e mbyll xhiron. Të dielën prej orës 15:00 takohen Vëllaznimi e Rahoveci. Vëllaznimi është i shtati me 11 pikë, por ka ende gjasa për të dalë në vendin e gjashtë, që siguron vazhdimin në Superligën A pas pjesës së rregullt të kampionatit. Rahoveci është në vendin e



pestë me 14 pikë, por ka një ndeshje më shumë se Vëllaznimi. "Vreshtarët" synojnë fitoren në Gjakovë për ngritje në tabelë.

## Joshua: Po ia rinisi nga e para për t'u rikthyer në majë

LONDËR, 10 SHKURT - Boksieri britanik Anthony Joshua, ish-kampion bote në peshën e rëndë, do të rikthehet në ring më 1 prill të këtij viti. Në stadiumin "O2 Arena" të Londrës ai do të përballlet me amerikanin Jermaine Franklin. Dy boksierët kanë dalë "ballë për ballë" në takimin e parë për

ta promovuar sfidën, që është vendimtare për të dy. Për Joshua kjo sfidë ka shumë rëndësi, pasi synon të rikthehet te fitorja pas dy humbjeve ndaj Oleksandr Usyk. "Nuk jam aspak i shkatërruar nga lufta dhe dy humbjet me Usyk. Jam ende i ri dhe i freskët, gati për të dueluar. Jermaine është një

rival i fortë. Unë gjithnjë i kam respektuar rivalët e mi", u shpreh Joshua. "Franklin po vjen për të dueluar me një ish-kampion bote, ndaj jam me këmbë në tokë. Gjatë gjithë karrierës time kjo është ndoshta periudha më serioze që po kaloj. Gjithçka që kam kaluar, pozitive apo negative,

po e përdor si motivim gjatë kësaj periudhe. Unë jam një person serioz që stërvitem dhe dueloj për të fituar, nuk jam aty për asgjë tjetër. Kam ulur kokën për t'u përgatitur për një luftë. Mund të rikthehem sërish në majë, jam i motivuar për të realizuar këtë gjë. Mund t'ia rinis nga e para dhe të



rikthehem në majë. Kjo më motivin", ka shtuar Joshua.

## Pensionohet Labinot Osmani

"Epoka e re"

PRISHTINË, 10 SHKURT - Labinot Osmani ka vendosur përfundimisht që të pensionohet nga futbollit aktiv. Një prej sulmuesve më të mirë në futbollin e Kosovës ka pasur një karrierë të jashtëzakonshme, duke luajtur me shumë klube dhe lënë gjurmë në secilin prej tyre. "Pas një rrugëtimi të gjatë si futbollist ka ardhur koha që këtij rrugëtimi t'i jap fund. Edhe pse shumë e vështirë ta merrja këtë vendim, mendoj se ka ardhur momenti t'i them lamtumirë futbollit aktiv", ka thënë fillimisht Osmani, i cili më pas falënderoi të gjitha klubet, kryesitë, trajnerët, bashkëlojtarët, tifozëritë dhe të gjitha qytetet e klubeve në të cilat ka luajtur për përkrahjen, vlerësimin dhe mikpritjen e ngrohtë që i kanë bërë në rrugëtimin e tij si futbollist. Osmani ka luajtur për



skadrën e Vushtrisë, Trepçës '89, Hysit, Prishtinës, Feronikelit, Llapit dhe Dukagjinit. "Një falënderim i veçantë për klubin e qytetit tim KF Vushtrria, klub në të cilin fillova karrierën time si futbollist. Ka qenë kënaqësi që të

kontribuoj sadopak në sukseset e klubit të qytetit tim. E nuk kam se si të mos i falënderoj tifozët e flaktë 'forca' për përkrahjen, vlerësimin dhe motivin që më kanë ofruar gjatë karrierës time", ka shtuar Osmani.

## Milwaukee mposhti lakersat, zhgënjejnë Denveri dhe Phoenixi

LOS ANXHELOS, 10 SHKURT - Katër ndeshje të luajtura në NBA, por mjaft surpriza. Ekipi i Denverit u mund me rezultat 115-104 nga Orlando, ndeshje ku për vendasit shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Carter me 19 pikë më i miri). Për Nuggetsit u dallua Gordoni me 37 pikë e Jokiqi me 29, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Humbja e tretë radhazi për lakersat, që u mundën në fushën e tyre me rezultat 115-106 nga Milwaukee. Giannis Antetokounmpo me 38 pikë e 10 rebounde ishte shënuesi më i mirë për Bucksin, ndërsa për vendasit mungoi LeBron Jamesi (Schroderi 25 pikë e Davis 23 pikë). Në



ndeshjet e tjera, ekipi i Brooklynit mposhti me rezultat 116-105 Chicagon, ndeshje ku shkëlqeu Dinwiddie, i ardhur vetëm pak ditë më parë, autor i

25 pikëve. Për Bulls, LaVine realizoi 38 pikë, por që mbetën për statistikë. Fiton edhe Atlanta, 116-107 ndaj Phoenixit, ku u dallua Trae Young me 36 pikë.

### Rezultatet

Orlando - Denver	115-104
Atlanta - Phoenix	116-107
Brooklyn - Chicago	116-105
Lakers - Milwaukee	106-115

### SHKURT

#### FIFA shpall tri kandidaturat për trajnerin më të mirë të 2022-s

FIFA ka shpallur tre finalistët e nominuar për çmimin e trajnerit më të mirë të FIFA-s për meshkuj. Gara është shumë e fortë pasi mes kandidaturave është trajneri kampion i Ligës së Kampionëve dhe Superkupës së Evropës, Carlo Ancelotti dhe trajneri që mori Kupën e Botës me Argjentinën, Lionel Scaloni. Treshen e plotëson Pep Guardiola i Manchester Cityt që e rrëmbeu titullin e Premierë Ligës.

#### Messi në dyshim për ndeshjen ndaj Bayernit

Pas Kylian Mbappe, edhe Lionel Messi është në dyshim të madh për ndeshjen e parë ndaj Bayern Munchenit në Ligën e Kampionëve, që do të luhet më 14 shkurt. Siç raportohet nga "L'Equipe", ylli argjentinës vuan nga një problem muskolor dhe me siguri do ta humbasë sfidën kundër Monacos në kampionat. Shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" luajti në 1/8 finale të Kupës së Francës, ku PSG-ja u eliminua nga Olympique Marseille dhe mbeti jashtë garës për të dytin sezon radhazi. Së bashku me Mbappe dhe Neymar, ata janë yjet e ekipit parisien, por sulmuesi francez dhe ai janë në dyshim të madh, të paktën për ndeshjen e parë ndaj "bavarezëve".

#### PSG-ja interesohet për Guardiolen

Manchester City po kalon një moment të vështirë pas akuzave të shumta nga Premierë Liga për thyerjen e "fair-play financiar". Për këtë arsye, trajneri i "qytetarëve", Pep Guardiola, është shprehur se do të largohet nga ata nëse këto akuzat dalin të vërteta. Menjëherë në sulm është hedhur PSG-ja, që kërkon të përfitojë nga rasti për ta bindur spanjollin. Trajneri francez Krisstofe Galtie është nën presion nga ana e drejtuesve dhe, ndoshta, mund të largohet për t'i lënë vend Guardiolen.

#### Ancelotti mund të bëhet trajner i Brazilit

Mediumet njohura botërore kanë shkruar për trajnerin aktual të Real Madridit, italianin Carlo Ancelotti. Sipas shumë burimeve, ai do të qëndrojë te klubi mbretëror deri në fund të këtij stinori, më pas do të emërohet trajner i Kombëtares së Brazilit. Shkrimet thonë se italianin veçse e ka pranuar kontratën dhe postin e trajnerit të Brazilit. Ndryshe, 63-vjeçari gjatë karrierës si trajner ka shumë tituj të rëndësishëm të fituar. 25 trofe të fituar i ka gjatë karrierës me skuadrat që ka drejtuar: me Juventusin, Milanin, Chelsea, Parisin, Real Madridin dhe Bayernin. Prej tyre i ka fituar katër Liga të Kampionëve, dy me Milanin, dy me Real Madridin.

## Fanella e Bryantit në ankand, shitet për 5.8 milionë dollarë

Fanella e Kobe Bryantit me ekipin e Los Angelesit, e veshur në sezonin 2007-2008, është shitur në ankand nga "Sotheby's" për shifrën e 5 849

700 dollarë, pak më pak se 5.5 milionë euro. Kjo është shuma e dytë më e lartë e paguar ndonjëherë për fanellën e një basketbollisti.

Rekordi absolut i takon Michael Jordanit në ndeshjen e parë të finaleve të NBA-së të vitit 1998, të shitur në ankand shtatorin e kaluar për 10

milione dollarë. Në klasifikimin absolut, mes Jordanit dhe Bryantit, shkëlqen legjenda Maradona. Fanella e tij e veshur në finalen e Kupës

së Botës 1986 për ndeshjen kundër Anglisë, dita ku Maradona shënoi golin e dorë, majin e kaluar është shitur për 9.28 milionë dollarë.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
NPL PËRPARIMI SH. A 1 - VUSHTRRI  
Nr: Protokolit: 124/23  
Data: 09.02.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. dhe 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. 121/23 të datës 09.02.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 09.02.2023 shpall:

### KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës "Sigurim Fizik")

- I. Titulli: Sigurim Fizik - roje  
Numri i ekzekutuesve: 1  
Orët e punës: 40 orë në javë  
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.  
Përgatitja profesionale: Shkolla Fillore  
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj  
I raporton: Udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik  
Koeficienti i pagës: 3.2

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdorë mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjegjësit udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

#### Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë fizike e preferuar;

#### Aplikacioni i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sille të noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës nëse ka;
- Kopjen e letërnjoftimit;

#### Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 13.02.2023 deri me datë 27.02.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
NPL PËRPARIMI SH. A 1 - VUSHTRRI  
Nr: Protokolit: 124/23  
Data: 09.02.23

Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, član 8 st. 4, član 11, član 21 pod st. i 2.2 i člana 25 Uredbe 55/21 o radnim odnosima NPL "Perparimi" Sh. A. u Vučitrnu odobreno 21.12.2021, na osnovu odluke br. 121/23 od 09.02.2023. od glavnog izvršnog direktora, N.P.L "Perparimi" Sh. A 09.02.2023 objavljuje:

### JAVNI KONKURS

(Za popunu radnog mesta „Fizičko obezbeđenje“)

- I. Naslov: Fizičko obezbeđenje  
Broj izvršilaca: 1  
Radno vreme: 40 sati nedeljno  
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme u periodu od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.  
Stručna priprema: Osnovna škola  
Radno iskustvo: Najmanje šest (6) meseci  
Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;  
Koeficijent plate: 3.2

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, mozetetakode je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

#### Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;

#### Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL "Perparimi" Sh. A. ;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uverenje o krivičnoj prošlosti koje ne sme biti starije od šest (6) meseci.
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i da se donosi u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci).

#### Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Peparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 13.02.2023 do 27.02.2023 u 16:00 časova.

N.P.L "Peparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 e Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotësim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111, si dhe Kodi Etikes dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi"SHA-Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me 09.02.2023, vendosi të rishpallë këtë:

### KONKURS Për plotësimin e pozitës:

#### Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë

I përgjegjjet: Bordit të Drejtorëve.

Vendi i Punës: Prishtinë

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Mandati për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është 3 vjeçar.

#### Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Të menaxhoj kompaninë në baza ditore në pajtim me aktet ligjore dhe politikën e kompanisë,
- Të zbatojë qëllimet strategjike dhe objektivat e kompanisë duke i dhënë drejtim lidhshëm drejt arritjes së misionit dhe vizionit të kompanisë,
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikën dhe vendimet që do t'i merr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron kompania duke mbikqyrë kualitetin e programit të përgaditjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjen e këtyre shërbimeve,
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordi i Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme,
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi,
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuara për të krijuar një pasqyrim pozitiv të kompanisë të palët e interesit,
- Mbikqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgaditjen e strategjisë për të i'u qasur këtyre burimeve duke ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve,
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (k) dhe (l) të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të vecanta:

- të kenë diplome universitare nga fusha ekonomike, juridike, teknike, shoqërore ose të ngjajshme.
- të kenë përvojë profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues në insitucione shtetërore ose ndërmarrje publike
- të kenë integritet të lartë moral e profesional,
- të kenë aftësi të dëshmuara në udhëheqje ose menaxhim,
- njohja e gjuhëve të huaja do të ketë përparësi,
- të mos jenë të dënuar ose nën hetime.

Aplikacionit për pozitën e KE-se duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ne (Biografine),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Planin personal zhvillimor strategjik të ndërmarrjes për 3 vitet e ardhshme
- Letër motivimin,
- Deklaratën nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,( e noterizuar )
- Certifikatën që nuk është nën hetime .

#### Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, përvojë 5 vjet në nivelin drejtues dhe në fusha që ndërlidhen me menaxhim të insitucioneve apo ndërmarrjeve publike, njohja e gjuhëve të huaja është e dëshiruar.

#### Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi i ri shpallur është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit, respektivisht nga data 11.02.2023 deri me 27.02.2023 .

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në Kompani, të njëjtit i bashkëngjiten dokumentet deklarata nën betim, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë nga trusti pensional, dëshminë për përvojën, dëshminë se nuk janë nën hetime apo të dënuar për vepra penale dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës, dokumentet të cilat pranohen pas afatit nuk shqyrtohen.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Pipina" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810847527.

- Sheqer Kamberi shpall të pavlefshme dëftesat vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Edmond Jahjaga shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB-Prishtinë, të lëshuar në vitin 2006.

- Zana Haraqija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Dardane Qela nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Armira Arifi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10,11,12,13 dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari"

- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408

- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.

- Shahin Arifi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLt : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).

- Blerta Gjeloshi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni"

- Lutfi Hajra shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani" ( ish Boris Kidric).

- Xhevdet Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".

- Mentor Bunjkau B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.

- Famous Club sh.p.k shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.

- Arbnor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Berat Bajraktari shpalle te pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Shefki Azemi shpalle te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.

- Rafet Durmishi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".

- Naser Hasani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.

- Mentor Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".

- Antigone Beka shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".

- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.

- Sh.P.K Broja Market shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.

- Granit Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Ora Travel SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811467168.

- Gabriell Prenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Nora Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl I te sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Jozef Tunprenkaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Don Shtjefen Kurti" Novosell e Epërme nga kl.I-V dhe VI-IX

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



## PASHTETË PULE

MEKA  
HALAL FOOD

gluten  
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues